

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPCË, *Departamenti i Pergjithshëm, Divizioni Penal,* gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në lënden penale kundër të akuzuarve B.A. dhe B.U. që të dy nga fshati ..., komuna e Shtërpcës, me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1892-8/15 e dt.30.10.2015 pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prani të perfaqesuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Agim Kuka, dhe të akuzuarve, me dt.29.02.2016, solli dhe publikisht shpalli kete:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. I akuzuari **B.A.** nga fshati ... komuna e Shtërpcës, i lindur me data e lindje..., nga i ati L... dhe e ëma H..., e gjinisë H..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, babë i një fëmije, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, i pa dënuar deri më tani , mbrohet në liri.
2. I akuzuari **B.U.** nga fshati ... , komuna e Shtërpcës, i lindur me data e lindje..., nga i ati H... dhe e ëma B..., e gjinisë S..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike , i pa dënuar deri më tani, mbrohet në liri.

J A N Ë F A J T O R Ë

Sepe me dt 30.09.2015 në orën 07:20, në rajonin pyjor Brod,në pyllin Shtetëror,në vendin e quajtur "Paralelja" nr.7,në bashkëveprim me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo personin tjetër,jan takuar nga rojet e pyllit duke prerë drunjët të pa damkosur dhe pa dokumentacion përkatës sasinë prej 3,50 m³ ,të cilët paraprakisht me motosharrë i kishte prerë,me të cilin veprim kanë dëmtuar Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik në Shtërpcë në vlerë prej 472,50 Euro (katërqindë e shtatëdhjetë e dy euro e pesëdhjetë cent).

Me të cilën kryen në bashkëkryerje veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës të sipërcituar dhe neneve 4, 17, 49, 50, 51, 52, dhe 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK-së të akuzuarit i

G J Y K O N

1. Të akuzuarin **B.A.** me denim me kushtë me burg prej 3 /tre/ muajve të cilin dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehura në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

2. Të akuzuarin **B.U.** me denim me kushtë me burg prej 3 /tre/ muajve të cilin dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohen të akuzuarit që të dëmtuarës DZHE-zyra në Shtetpcë në mënyrë solidarë t'ia kompensojnë dëmin e shkaktuar në shumën prej 475,83 Euro (katërqindë e shtatëdhjetë e dy euro e pesëdhjetë cent).

Obligohen të akuzuarit që në emer të shpenzimeve gjyqësore-paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 30 Euro, në mënyrë solidarë, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/Inr.1892-8/15 e dt.30.10.2015 ka ngarkuar të akuzuarit B.A. dhe B.U. që të dy nga fshati... , komuna e Shtërpcës, me të cilën në bashkëkryerje kryen veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt.29.02.2016 ku ka ftuar të akuzuarit që të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor si dhe e ka udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 323 par.2.1, 2.2 dhe 2.3 të KPPK-së.

Gjyqtari ka ftuar prokurorin e shtetit Agim Kuka që edhe në shqyrtimin gjyqësor t'a lexon aktakuzën të akuzuarëve me të cilët janë të ngarkuar nga prokurori e shtetit.

Pas leximit të akuzës nga prokurori i shtetit gjyqtari është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar në tërësi përmbajtjen e aktakuzës dhe të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohen mbi fajsinë apo pafajësinë e tyre për veprën penale për të cilën janë ngarkuar.

I akuzuari B.A. edhe në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar fajsinë për verën penale që akuzohet.

I akuzuari B.U. edhe në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar fajsinë për verën penale që akuzohet.

I akuzuari B.A. në mbrojtjen e dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se ditën për të cilën akuzohet ka shkuar së bashku me B.... në pyll për të mbledhur dru të thata ku kemi marrur

litarin për ti grumbulluar dhe kisha marrur soaten me vete dhe nuk është e vërtet se kanë prerë drunjë të njomë të ahut.

I akuzuari B.U. në shqyrtimin gjyqësor në mbrojtjen e tij ka deklaruar se se është e vërtetë se atë ditë së bashku me B.... kanë shkuar në pyll ku ka marrur edhe motorr sharren për ti shkrtuar drunjët që i grumbullojn mbeturinat dhe drunjë e thatë që do ti gjejnë dhe është evërtetë se B.... kishte marrur sopaten dhe konopin për tërheqje të drunjëve e ky motorrsharrendhe litarin.Ishte dita e parë që kishte shkuar në pyll për të mbledhur mbeturina apo degë të thata për nevoja të familjes,por dikush më par kishte prer edhe drunjë të njom dhe trupat e trashë i kishin marrur kurëse ne kemi bledhu degët dhe i kemi shkurtuar.

Dëshmitari rojtari i pyllit në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me dt.30.09.2015 në ora 720 në paralelen 7 kanë hasur B.A. dhe B.H. ku i akuzuari B... ishte duke shkurtar drunjë në metër ku aty ishi duku 3,5 mrtra kub dhe se drunjët ishin të perë nga këto të dy jo dega por nga rrënjët.

Dëshmitari S.H. ndimës i ojtarit të pyllit ka deklaruar se është e vërtet se i ka takuar të dy të akuzuarit dhe i njeft mirë pasi jantë të dy bashkëfshatar dhe drunjët nga vendi ku i kishin prerë i kishin tërhequr më posht dhe iishin duke shkurtuar për bartje ku në mesin e drunjëve ka patur edhe të thata edhe të njoma.Në vazhdim ka thekësuar se drunjët ishin të diametrit 15-20 cm e më të hollat ishin 8-10 cm,ku sjelljet e tyre ishin korekte.

Gjykata pas zbatimit të provave dhe vlersimit të tyre një nga një dhe të gjitha në tërsinë e tyre konformë dispzitive ligjore të nenit 8 dhe 361 pag.1 dhe 2 të KPPRK-së vërtetoi këtë gjendje faktike:

Të akuzuarit me dt.30.09.2015,në orën 07:20,në rajonin pyjor Brod,në pyllin Shtetëror,në vendin e quajtur "Paralelja" nr.7,në bashkëveprim me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo personin tjetër,jan takuar nga rojet e pyllit duke prerë drunjët të pa damkosur dhe pa dokumentacion përkatës sasinë prej 3,50 m³ / kubë/ ,të cilët paraprakisht me motosharrë i kishte prerë,me të cilin veprim kanë dëmtuar Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik në Shtërpçë në vlerë prej 472,50 Euro.

Nga dëshmi Nga dëshmit e dëshmitarëve gjykata vërteton swe të akuzuarit e kanë kryer vepren penale që akuzohen pasi kjo u vërtetua edhe gjashtë ballafaqimit me dëshmitarët në shqyrtimin gjyqësor se të njejtit janë takuar në vendin ku e kanë shkaktuar dëmin e mbrojtjen e tyre ishte vetë shmangja nga përhgjegjësia penale por gjykata nuk i fali besim një brojte t të tillë. Dëshmive të sipërcekura gjykata i shprehu besimin e plotë dhe i vleronë si bindëse dhe reale pasiqë të njejtat janë në përputhshmëri të plotë me njëra tjetrën.

Gjykata provat e lartëcekura i vleronë si bindëse pasiqë të njejtat në harmoni me fletëparaqitjen e rojës së pyllit me vlerësim dhe llogaritjen e dëmit të pyllit me nr.153/2015 e datës 05.10.2015.

Mbrojtjes së të akuzuarit se nuk ka ndermarrë veprimet inkriminuse siq përshkruhet në dispoizitiv se nuk e ka sulmuar të dëmtuarin e vlerëson si të pabazuar, të pa argumentuar dhe e orientuar në shmangien e veprimeve inkriminuse ku nuk e ka aprovuar pasi që nga dëshmitë e

të dëmtuarëve dhe pjesërisht nga deponimi dëshmitarit dhe pjesërisht të akuzuarit është vërtetuar se ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në datën dhe kohë të caktuar e ka kryer me dashje direkte pasi që ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe njëkohësisht ka dëshiruar ardhjen e pasojave.

Gjykata provave të lartëcekura u shperhu besimin e plotë dhe i vleronë si bindëse të cilat plotësohen reciprokisht dhe nuk gjeti nëdonji arsye të mosë u a shprehur besimin.

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha tiparet e vepres penale të cilën kryen në bashkëkryerje veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par 1. lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrahanat në kuptim të nen. 73 të KPRK- së cilat ndikojnë në llojinë dhe lartësinë e dënimit. Si rrethana lehtësuese gjykata mori se të akuzuarit janë të pa punë, kanë premtuar se më asnjëherë nuk do të përsëris veprime të tilla, nuk ka të dhëna se te ketë qenë i dënuarë më parë me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, duke qenë e bindur se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv veç e veç me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3/tre/ muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryenë vepër tjetër penale brenda periudhës kohore prej 1/një/ viti nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale tek i akuzuari të ndikoi që në të ardhmen mos të kryerjë vepra penale dhe që personat e tjerë të përmbahen nga kryerja e vepra penale konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPPK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari- Sektori i Pylltarisë në Shtërpcë të kompenzoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 475,83 € (katërqindë e shtatëdhjetë e dy euro e pesëdhjetë cent).

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.1 dhe 6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPECË
P.nr.122/2015 me datë 29.02.2016

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.